Prof.Ass.Dr. AFRIM KOCA

# NDRYSHIMET E DIMENSIONEVE ANTROPOMETRIKE, LËVIZORE DHE TË LËVIZJEVE SITUACIONALE NË MES DY GRUPEVE TË HENDBOLLISTËVE JUNIORË TË SUPERLIGËS SË KOSOVËS

MONOGRAFI

Botues:
Botime Rozafa

Recensentë:
Prof. Dr. Bujar Turjaka
Prof. Asoc. Dr. Abdulla Elezi

Prof.Ass.Dr. AFRIM KOCA

# NDRYSHIMET E DIMENSIONEVE ANTROPOMETRIKE, LËVIZORE DHE TË LËVIZJEVE SITUACIONALE NË MES DY GRUPEVE TË HENDBOLLISTËVE JUNIORË TË SUPERLIGËS SË KOSOVËS

MONOGRAFI

Shtëpia botuese
ROZAFA
Prishtinë
2021

*Familjes time në përgjithësi,*
*E fëmijëve të mijë në veçanti.*

P Ë R M B A J T J A

1. HYRJE ........................................................................................ 7
2. PASQYRA E DISA HULUMTIMEVE TË DERITANISHME.............. 11
3. QËLLIMI I HULUMTIMIT ................................................................ 17
3.1. HIPOTEZAT THEMELORE .............................................................. 18
4. METODAT E PUNËS ..................................................................... 19
4.1. Mostra e të hulumtuarëve................................................................ 19
4.2. Mostra e ndryshoreve..................................................................... 20
4.2.1 Mostra e ndryshoreve antropometrike20
4.2.2 Përshkrimi i teknikës së matjeve të ndryshoreve antropometrike ..... 22
4.2.3 Grupi i instrumenteve matëse të ndryshoreve lëvizore ...................... 30
4.2.3.1 Testet lëvizore bazike.................................................................. 30
4.2.3.2 Testet lëvizore situacionale.......................................................... 30
4.3. Përshkrimi i instrumenteve matëse lëvizore bazike............................. 31
4.4 Përshkrimi i instrumenteve matëse të lëvizjeve situacionale ................ 37
5. MËNYRA E ZBATIMIT TË HULUMTIMIT ...................................... 41
5.1. METODA E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE............................. 42
6. REZULTATET DHE DISKUTIMET .................................................. 43
6.1. Treguesit themelorë statistikorë në hapësirën antropometrike
dhe lëvizore në matjet e hendbollistëve. .............................................. 43
6.1.1 Treguesit themelorë statistikorë në hapësirën lëvizore
në matjet e hendbollistëve.................................................................. 46
6.2. NDËRLIDHJET E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE
MANIFESTE ..................................................................................... 49
6.2.1. Ndërlidhjet e ndryshoreve në hapësirën antropometrike
manifeste të hendbollistëve.................................................................. 49
6.3. NDËRLIDHJET E NDRYSHOREVE LËVIZORE MANIFESTE ..... 51

6.3.1. Ndërlidhjet e ndryshoreve në hapësirën lëvizore manifeste
të hendbollistëve ........................................................................ 51
6.4. KROSKORELACIONET NË MES TË NDRYSHOREVE
ANTROPOMETRIKE DHE LËVZORE............................................. 53
6.4.1 Kroskorelacionet ndërmjet ndryshoreve antropometrike dhe lëvizore
në hapësirën manifeste të hendbollistëve.......................................... 53
6.5. FAKTORIZIMI I HAPËSIRËS MANIFESTE.................................... 55
6.5.1 Faktorizimi i hapësirës antropometrike të hendbollistëve ................. 55
6.5.2 Faktorizimi në hapësirën lëvizore të hendbollistëve........................... 61
6.6. KORELACIONI I FAKTORËVE NË HAPËSIRËN LATENTE ....... 67
6.7. ANALIZA DISKRIMINATIVE NDËRMJET DY ENTITETEVE .... 68
6.7.1 Analiza diskriminative në hapësirën antropometrike
ndërmjet entiteteve.......................................................................... 68
6.7.2 Analiza diskriminative në hapësirën lëvizore ndërmjet dy grupeve... 71
6.8. NDRYSHIMET NË HAPËSIRËN MANIFESTE................................ 75
6.8.1 T- Testi për ndryshoret antopometrike dhe lëvizore ndërmjet
dy grupeve......................................................................................... 75
7. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE............................................................... 79
8. PËRFUNDIMI ........................................................................................ 81
9. SUMMARY OF TOPIC ......................................................................... 85
10. L I T E R A T U R A.............................................................................. 89
11. SH T O J C Ë.......................................................................................... 95

# 1. HYRJE

Ai që merret me hulumtimin e dimensioneve antropometrike, hapësirës lëvizore (motorike) dhe lëvizjeve situacionale të moshat e reja ka detyrimin e njohjes së karakteristikave që ka secili organizëm në secilën fazë moshore, në mënyrë që ti kuptojnë më lehtë kërkesat për të propozuar një aktivitet lëvizor (motorik) të ekuilibruar dhe efikas, duke garantuar për sportistët e rinjë, efekte përfituese të një aktiviteti fizik të shëndetshëm dhe me rezultate të mira edhe në moshë të rritur.

Kur bëhet fjalë për proceset transformuese, njohja e relacioneve ndërmjet dimensioneve të ndryshme të statusit psikosomatik të njeriut, posaçërisht ndërmjet dimensioneve antropometrike, hapësirës lëvizore dhe lëvizjeve situacionale, është shumë e rëndësishme dhe mu për këtë është sferë e hulumtimit të shumë hulumtuesve sidomos në lëmin e kulturës fizike.

Hulumtimet në lëmin e statusit morfologjik, posaçërisht të teorive dhe të lidhjeve të tyre reciproke, janë bërë shumë më herët, ndërsa në lëndën e kulturës fizike, hulumtime të rëndësishme të kësaj natyre datojnë në fillim të shekullit të kaluar.

Këto hulumtime janë të rëndësishme për faktin se informatat e fituara nga analizat e këtyre raporteve pasqyrojnë qartë lidhmerinë dhe varshmërinë ndërmjet dimensioneve antropometrike dhe lëvizore, e që janë të rëndësishëm në përzgjedhjen dhe planifikimin e programimit të proceseve transformuese të sportistëve të rijnë. Ndërlikushmeria e sistemit multidimensional të statusit psikosomatik vie në pah sidomos gjat periodave të rritjes dhe zhvillimit të organizmit, ku raportet e relacioneve ndërmjet

dimensioneve vazhdimisht ndryshojnë dhe mu për këtë njohja e faktorëve nga të cilët varet suksesi në lëmi të caktuara punuese paraqet sfidë për punëtorët shkencorë, të cilët me anë të metodave hulumtuese shkencore arrijnë deri në njohjen, shpjegimin e lidhmërin si dhe gjetjen e modeleve më të përshtatshme të raporteve në mes faktorëve, që suksesi në punë të jetë maksimal.

Përzgjedhja e tipave sportivë me karakteristika tipike morfologjike që premtojnë rezultate të mira sportive, e sidomos tipologjia konstitucionale në sporte të caktuara ka rëndësi të madhe. Në shumë sporte vihet re se suksesi i tyre është i lidhur me një tipologji të përcaktuar përbërëse, do me thënë me një somatotip të caktuar. Ky fenomen mund tu bashkëngjitet për shembull ligjeve biomekanike, që janë në bazë të teknikave sportive të caktuara, ose në procese fiziologjike, që janë të ndryshme midis tyre dhe varën nga motivet që kërkohen. Për këtë arsye në disa sporte përmasat e trupit marrin një rëndësi të veçant përsa i përkëtë mundësive të lëvizjes dhe rezultateve në sport. Për shembull janë të dukshme mundësitë që kanë lojtarët e basketbollit, apo të volejbollit me një shtat shumë të lartë, ose hendbollistët me një shtat më të shkurtër.

Fakti se njeriu dhe lojërat kolektive paraqesin sistem të ndërlikuar, ku dimensionet e ndryshme dhe niveli i manifestimit të tyre, janë në ndërvarshmëri me gjendjen e dimensioneve dhe të organizmit në tërësi, si dhe puna me ekipet e lojërave kolektive, me këtë rast në lojën e hendbollit, nga këndvështrimi i strukturës faktoriale dhe nga aspekti tekniko taktik janë dy kahje që jepin një tërsëi, ku asgjë nuk mund të analizohet e ndarë, e bënë këtë proces tejet të komplikuar.

Në këto ndërlikushmeri kam hasur gjat hulumtimeve të mia me ekipet e hendbolli të superligës së Kosovës, që janë pjesë e këti hulumtimi.

Nëse e vështrojmë për nga përbërja, hendbolli është lojë kolektive që bazohet në situata, për nga struktura e lëvizjes bënë pjesë në grupin e

sporteve polistrkturale. Në fakt mbajtja e topit në mënyrë spektakulare, goditja, pranimi, pasimi dhe lëvizjet pa top në sulëm dhe mbrojtje, varën në mënyrë cilësore nga parametrat antropometrik, hapësirës lëvizore dhe lëvizjeve situacinale që në vete ngërthen forcë, shpejtësi, rezistencë, koordinim, ekuilibër, precizitet dhe ritëm të lojtari.

Për vet karakteristikat e popullit tonë, hendbolli është një sport mjaft i përshtatshëm për cilësitë që zotëron rinia jonë, si janë: shpejtësia, agresiviteti, forca e tjera.

Hulumtimi në këtë projekt është përqendruar në strukturën dhe ndryshimet e dimensioneve antropometrike, lëvizore dhe të lëvizjeve situacionale në mes të katër ekipeve më të mira, që u ranguan në kreun e tabelës dhe katër ekipeve tjera, që mbetën në fundin e tabelës të superligës së Kosovës në hendboll për të rinjë.

Decenia e fundit e shekullit të kaluar, si në të gjitha poret e jetës edhe në lëmin e hulumtimeve shkencore në Kosovë, pat stagnim të madh, e poashtu rrethanat që mbretëruan në atë periudhë lan pasoja të mëdha edhe në zhvillimin fizik dhe psiqik të popullatës sonë, e sidomos të të rinjëve. Dhe mu për këto arsye çdo krahasim i rezultateve të këtij hulumtimi me hulumtimet tjera të kësaj natyre, duhet të merret parasysh periudha shumë e vështirë që u rriten, ushtruan dhe garuan këta të rinjë.

# 2. PASQYRA E DISA HULUMTIMEVE TË DERITANISHME

Që nga kohërat e vjetra, njeriu ka shfaq interesim rreth shpjegimit të aftësive lëvizore, si dhe ti njoh raportet e madhësive në mes të pjesëve të ndryshme të trupit, duke qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e tyre për ekzistencën e tij.

Përparimet në hulumtimet e natyrës kinozolgjike bëhen të mundshme pas përparimeve shkencore nga lëmia e metodologjisë matematikore, ku me aplikimin e analizave statistikore është mundësuar definimi i qartë i dimensioneve të sistemit njeri, si sistem shumë dimensional.

Analizat studiuese dhe profesionale kanë filluar të paraqiten në fund të shekullit të XVIII-të dhe në fillim të shekullit XIX-të në hulumtimin e karakteristikave antropometrike, që pastaj të zgjërohen edhe në karakteristika fiziologjike, ndërsa hulumtimet e kësaj natyre në lëndën e kulturës fizike datojnë në fillim të shekullit të kaluar.

Në hulumtimin e këtyre dimensioneve, përballë matjeve antropometrike dhe lëvizore, autorët kanë shfrytëzuar edhe indeksa të ndryshëm: (Lorentzov, Bozherov, Quetelov), ndërsa të testuarit janë trajtuar përmes disa grupeve tipologjike në bazë të metodave (Kretschmer, Sheldon, Bunka, Conrad).

Hulumtuesit më të njohur në lëmin e hulumtimeve të karakteristikave morfologjike kanë qenë: Arnold (1933), Shkarlj (1936), Smodlaka (1946-1950), Medved (1953), Novotin (1958), Toner (1960), Hofman (1966), Zaciorski (1977), Hoshek, Momiroviq (1980 -1989), Medved, Ivanek (1992) e shumë autorë të tjerë.

**Shep, Horvat** (1962), më bashkpuntorë, kanë bërë hulumtimin më voluminoz të dimensioneve morfologjike në kuadër të 68.000 të testuarëve të moshës 8-19 vjeçare, me ç'rast kanë matur katër dimensione: lartësinë, peshën, vëllimin e gjoksit dhe të shputës.

**D. A. Sargent** ka konstruktuar baterinë e parë të testeve motorike të quajtur " Testi universal i forcës, shpejtësisë, qëndrushmërisë së trupit.[1]

**McCloy** (1934), ka sprovuar analizën e parë faktoriale të baterisë së testeve situacionale, motorike, dimensionet latente të interpretuar si forcë, shpejtësi dhe koordinim të grupeve të mëdha muskulore.[2]

**Qitaku. F.** (1985), në hulumtimin "Struktura latente e precizitetit"[3] ka bërë hulumtime me nxënësit e shkollave të mesme të moshës 18 vjeçare në komunën e Lipjanit, të Pejës dhe të Podujevës. Për këtë hulumtim ka pasur gjithsej 32 variabla të precizitetit motorik, ndërsa numri i entiteteve ishte 496 nxënës. Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ka qenë konstatimi i strukturës primare të precizitetit latent. Në këtë hulumtim është punuar me analizën faktoriale latente të strukturës së precizitetit, me ç'rast janë vërtetuar tre nivele të strukturës latente të precizitetit.

**Gjinolli. E.** (1997), në temën "Karakteristikat antropometrike të vlefshme për volejboll të nxënësit e klasës së pestë të shkollës fillore"[4] ka bërë hulumtimin duke pasur qëllim thelbësor antropometrinë dhe motoriken me nxënësit me orientim në volejboll. Në faktorizimin e hapësirës antropometrike janë izoluar dy dimensione latente antropometrike: në

---

[1] Kurelija. N. I saradnici, 197². Rađa. I. "Monografija". FKF. Sarajevo 1998
[2] Rađa. I. "Monografija" . FKF. Sarajevo 1985
[3] Çitaku. F. "Disertacioni i doktoraturës". FKF. Zagreb 19
[4] Gjinolli. E, "Disertacionoi i doktoraturëe". FKF. Prishtinë 1997

analizën regresive në mostrën e variablave predikore janë përfshirë 18 variabla antropometrike, kurse në atë motorike 10.

**ALIU. M.** (1991), në disertacionin e doktoraturës me temën: “Zhvillimi morfologjik dhe disa karakteristika motorike të popullatës dhe diferenca në ato karakteristika kronologjike të moshës së caktuar”[5], mostra e testurve ka qenë ndarë në tri submostra (15, 16 dhe 17 vjeçare) në bazë të rezultateve të faktorizimit në hapësirën antropometrike janë izoluar tre dimensione latente antropometrike: dimensioni i skeletit cirkular, indi dhjamor nënlëkuror dhe dimensioni i skeletit transversal, ndërsa në hapësirën latente antropometrike, për submostrën 17 vjeçare, janë ekstraduar tre faktorë latentë lëvizor të definuar si:

- Faktori i ekuilibrit me sy të mbyllur dhe të hapur.
- Faktori i sprintit.
- Faktori i forcës eksplozive.

**KASA, A.** (1996), në eksperimentin me fëmijët e moshës 10 – 14 vjeçare nga Tirana (mëshkujt dhe femra)[6][6] ku në këtë punim autori analizon gjendjën e aftësive të përgjithshme motorike dhe krahasimin e tyre me moshatarët e vendeve të tjera. Në bazë të rezultateve të eksperimentit ka rezultuar se fëmijët tanë janë të nivelit me ata të vendeve të tjera, në shumicën e elementeve psikofizike, me një ngecje të theksuar në rregullimin struktural të lëvizjeve, përkatësisht në testet e koordinimit.

**SELIMI. M.** (2001), në punimin e tij ka bërë vlerësimin e parametrave antropometrik dhe motorik të futbollistëve të Anamoravës,[7][7] me ç’rast ka përdorur analizën faktoriale dhe iu kanë ekstrahuar tre faktorë

[5] Aliu. M. “Disertacioni i doktoraturës”. Sarajevë 1991
[6] Kasa. A. ILKF. “Vojo Kushi”. Tiranë 1996
[7] Selimi. M. “Punim magjistrature”. FKF. Prishtinë 2001

latent në hapësirën antropometrike dhe tre faktorë latentë motorik të emërtuar si:

- Faktori longitudinal dhe transversal i skeletit.
- Faktori i dimensionit cirkular dhe i masës së trupit.
- Faktori i dimensionit cirkular dhe transversal i gjymtyrvë të poshtme.

Ndërsa në hapësirën motorike:

- Faktori i fleksibilitetit dhe i aftësive të lëvizjeve specifike me top.
- Faktori i udhëheqjes së topit në gjysmërreth dhe agjilitetit.
- Faktori i shpejtësisë së udhëheqjes së topit dhe i forcës eksplozive.

**RUSHITI. H.** (2001) në punimin e ti të doktoratës “Struktura dhe relacionet ndërmjet faktorit gjeneral të forcës dhe mekanizmit të rregullimit strukturor të lëvizjëve”[8][8], në mostrën prej 198 studentëve, i ka trajtuar me 21 variabla lëvizore. Ka arritur në ekstrahimin e pesë faktorëve latent:

- Faktori i forcës repetitive.
- Faktori i agjilitetit.
- Faktori i forcës dinamometrike.
- Faktori i forcës eksplozive të këmbëve.
- Faktori i realizimit të shpejtë të detyrave komplekse.

**IVANISHEVIQ. K.** (1982) në hulumtimin “Analiza komparative e strukturorës së aftësive motorike të të rinjtë e gjinisë mashkullore dhe femërore”[9][9] me mostrën prej 391 femrave dhe 338 mëshkujve të moshës 17 vjeçare, të cilët i ka trajtuar me 36 ndryshore lëvizore, ka përcaktuar strukturë latente të kësaj hapësire dhe ndryshimet e mundshme ndërmjet dy gjinive. Të gjinia femërore i janë ekstrahuar katër mekanizma latentë të

---

[8] Rushiti. H. “Disertacioni i doktoraturës”. FKF. Prishtinë 2001
[9] Rushiti. H. “Disertacioni i doktoraturës”. FKF. Prishtinë 2001

rendit të dytë, ndërsa të gjinia mashkullore pesë faktorë latentë lëvizorë: forcën eksplozive, forcën repetitive dhe statike, shpejtësinë e frekuencave lëvizore, si dhe baraspeshën dhe fleksibilitetin.

Gjithashtu ka konstatuar ndryshime ndërmjet dy gjinive sa i përket strukturës së hapësirës lëvizore.

**ARIFI. F.** (2003) në punimin e tij të magjistraturës "Ndryshimet e dimensioneve antropometrike dhe lëvizore ndërmjet nxënësve futbollistë dhe atyre jofutbollistë të moshës 13 vjeçare"[10], në punimin e tij nëpërmjet analizave faktoriale, t-testit, analizës diskriminative ka vërtetuar së ekzistojnë ndyshime në hapësirën antropometrike dhe at lëvizore e sidomos ndryshime të vlefshme statistikore janë paraqitë në ndryshoret lëvizore dhe në ato situacionale.

**RAKOVICA. H.** (1998) në hulumtimin "Hapësira motorike e fëmijëve të moshës 11 vjeçare dhe faktorizimi i saj"[11], në mostrën prej 300 nxënësve ka trajtuar aftësitë motorike të tyre përmes 14 testeve. Me analizën faktoriale ka ekstrahuar 4 faktorë latentë të hapësirës lëvizore:

- Faktori i shpejtësisë dhe i forcës.
- Faktori i forcës statike dhe përsëritëse i këmbëve.
- Faktori i lëvizshmërisë së këmbëve.
- Faktori i forcës statike dhe përsëritëse të këmbës.

**I njëjti autor**,(1990) në punimin "Struktura faktoriale e dimensioneve antropometrike"[12], në mostrën prej 242 nxënësve të moshës 17-18 vjeçare

---

[10] Arifi. F. "Punim magjistrature". FKF. Prishtinë 2003
[11] Rakovica. H. "Acta kinezologica" faq. 17 dhe 20-35 Prishtinë 1998
[12] Rakovica. H. "Acta kinesiologica". Prishtinë 1990

ka aplikuar 16 ndryshore antropometrike. Në bazë të rezultateve të dala nga faktorizimi janë ekstrahuar 3 faktorë latentë antropometrik:

- Faktori i indit dhjamor nënlëkuror.
- Faktori longitudinal skeletit.
- Faktori i volumit dhe i masës.

# 3 . QËLLIMI I HULUMTIMIT

Struktura, ndryshimet dhe ndërlidhjet e dimensioneve antropometrike dhe lëvizjeve bazike, si dhe të lëvizjeve situacionale të supërliges së Kosovës në hendboll për juniorë, nuk ka qenë objekt i asnjë hulumtimi deri tani.

Duke u nisur nga mostra e të testuarëve, nga testet e aplikuara dhe metodat e shfrytëzuara, qëllimi i këtij hulumtimi është të vihen në pah ndryshimet dhe ndërlidhjet në tri hapësirat: antropometrike, lëvizjeve bazike dhe të lëvizjeve situacionale ndërmjet katër ekipeve të hendbollit qe ishin të renditura në krye të tabelës dhe katër ekipeve që mbetën në fundin e tabelës të superligës së Kosovës për të rinjë.

Pra, qëllimin kryesor të këtij hulumtimi mund ta përmbledhim në:

- Vërtetimi i relacioneve të hapësirës antropometrike, dhe testeve lëvizore.
- Vërtetimin e ndërlidhjes në hapësirën manifeste antropometrike dhe lëvizore.
- Vërtetimi i ndryshimeve të dimensioneve antropometrike dhe lëvizore në hapësirën manifeste, e sidomos të lëvizjet situacionale, ku dhe pritet të vërtetohen ndryshime në mes dy grupeve.
- Vërtetimin e ekzistimit të faktorëve të rëndësishëm në të dy hapësirat manifeste dhe latente dhe të relacioneve ndërmjet tyre.
- Vërtetimin e ndryshimeve në hapësirën latente në mes të faktorëve.

## 3.1. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të qëllimit të këtij hulumtimi, si dhe nga mostra e të testuarëve dhe nga testet e aplikuara dhe duke u mbështetur në faktet e vërtetuar nga një numër i konsderushëm hulumtimesh të ngjashëm, janë parashtruar këto hipoteza:

**H1**: Pritet së do të fitohën kroskorlacione të rëndësishme në mes të hapësirës manifeste antropometrike dhe lëvizore.

**H2:** Pritet së do të ekstradohen tre faktorë latentë në hapësirën antropometrike të dy grupet të hendbollistëve.

**H3**: Pritet së do të ekstradohen tre faktorë latentë në hapësirën lëvizore të dy grupeve të hendbollistëve .

**H4**: Pritet të vërtetohen ndryshimet ndërmjet dy grupeve në hapësirën antropometrike, lëvizore dhe lëvizjeve situacionale.

# 4. METODAT E PUNËS

## 4.1. Mostra e të hulumtuarëve

Në këtë hulumtim mostra e të hulumtuarëve është marrur nga tetë klubet e hendbollit të të rinjëve të superligës së Kosovës.

Numri i përgjithshëm i të testuarve është 128 hendbollistë, të cilët u janë nënshtruar matjeve ne 9 ndryshoreve antropometrike dhe 10 ndryshoreve lëvizore, ku u kryen gjithsejtë 2432 matje.

Ekipet që u testuan për këtë hulumtim janë:

1. Gjashtëmdhjetë lojtarë të K.H. “Trepça” nga Mitrovica
2. Gjashtëmdhjetë lojtarë të K.H. “Kastrioti” nga Ferizaj
3. Gjashtëmdhjetë lojtarë të K.H. “Besa Famiglia” nga Peja
4. Gjashtëmdhjetë lojtarë të K.H. “Prishtina” nga Prishtina
5. Gjashtëmdhjetë lojtarë të K.H. “Kosova” nga Vushtrria
6. Gjashtëmdhjetë lojtarë të K.H. “Liridoni” nga Deçani
7. Gjashtëmdhjetë lojtarë të K.H. “Drenica” nga Gllogoci
8. Gjashtëmdhjetë lojtarë të K.H. “Vjosa” nga Shtimja

Duhet cekur së të gjithë lojtarët kanë kaluar procedurat paraprake të seleksionimit dhe ishin aktiv në lojërat e kampionatit, ku atëherë është e natyrshme së të gjithë ishin të aftë dhe të vullnetshëm në aspektin psikofizik për tu testuar.

### 4.2 Mostra e ndryshoreve

Mostra e instrumenteve matëse në këtë hulumtim është zgjedhur nga punimet e deritanishme, në bazë të të cilave na mundësohet vlerësimi dhe interpretimi i disa dimensioneve antropometrike, lëvizore dhe lëvizjeve situacionale të të dy grupeve të hendbollistëve. Grupi i parë përbëhet prej katër ekipeve të cilat gjënden në krye të tabelës e që ishin: Trepça, Kastriot, Besa Famiglija dhe Prishtina, ndërsa në grupin e dytë katër ekipet qe u radhiten në fundin e tabelës në superligën e Kosovës në hendboll për të rijnë e që ishin: Kosova, Liridoni, Drenica dhe Vjosa.

Testimi u bë në fund të edicionit të garave 2007/08. Këto ndryshore janë aplikuar edhe në hulumtimet e mëparshme shkencore dhe i plotësojnë të gjitha kriteret metrike për qëllimin e këti hulumtimi.

#### 4.2.1 Mostra e ndryshoreve antropometrike

Që nga ekzistimi i njeriut, karakteristikat trupore dhe zhvillimi i aftësive të tyre, paraqiste sfidë për ti njohur dhe shpjeguarat ato.

Në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX fillojnë të bëhen analiza studiuse dhe profesionale në lëmin e statusit morfologjik. Caktimi i strukturës latente të dimensioneve antropometrike të njeriut në mënyrë të ngushtë është i lidhur me zhvillimin e ndryshimeve faktoriale të teknikave analitike.

Variablat (ndryshoret) antropometrike për këtë hulumtim janë marrë nga programi biologjik internacional "IBP" dhe matjet janë bërë në bazë të këtij programi.

Në këtë hulumtim janë aplikuar nëntë variabla antropometrike të cilat hipotetikisht mbulojnë tre faktorë latent: vlerësimi i dimensionit të volumit

dhe masës së trupit, i dimensionit longitudinal të skeletit dhe definimi i dimensionit transversal të skeletit.

1. APESHA – Pesha e trupit
2. ALARTE – Lartësia e trupit
3. AGJKR - Gjatësia e krahut
4. AGJASHU- Gjatësia e shuplakës
5. AGJRSHU- Gjërësia e shuplakës
6. AGJRBIK – Gjërësia bikristale
7. APEGJO - Perimetri i gjoksit
8. APEKR – Perimetri i krahut
9. APEBEL – Perimetri belit

### 4.2.2 Përshkrimi i teknikës së matjeve të ndryshoreve antropometrike

**1. APESHA.-** Pesha e trupit matët me peshojë decimale lëvizëse, e cila mundëson saktësinë e matjës prej 0.1 kg. Peshoja është e domosdoshme të vëhët në pozitë horizontale, dhe për çdo ditë para përdorimit dhe pas 10 matjeve të bazhdarohet. I maturi është i zbathur, në brekë të shkurtër, qëndron në këmbë i qetë në mes të peshojës. Pasi që treguesi të qetësohet, rezultati lexohet me saktësi 0.1 kg.



Foto 1

**2. ALARTË-** Lartësia e trupit matet me antropometër sipas Martinit. Gjat matjës i testuari duhet të jetë i zbathur dhe me brekë të shkurtër, të qëndrojë në këmbë në bazën e fortë horizontale. Koka e të testuarit duhet të jetë në pozitë, që vija e cila e bashkon skajin e sipërm të zgavrës së jashtme të organit të dëgjimit, të jetë në horizontale me skajin e poshtëm të zgavrës së syrit (i ashtuquajturi rrafshi i Frankfurtit). I testuari e drejton shpinën aq sa është e mundur, ndërsa shputat i bashkon. Matësi qëndron në anën e majtë të maturit dhe e kontrollon se a është vënë antropometri saktësisht përgjat anës së prapme dhe vertikalisht, pastaj e zbret krahun e antropometrit që është horizontalisht, deri sa ai të prekë kokën e të maturit. Atëherë e lexon rezultatin në shkallën, në lartësinë e pjesës së epërme të trekëndëshit, në lartësi të rrëshqitësit. Rezultati lexohet prej 0.1 cm.



Foto 2

**3. AGJKR-** Gjatësia e krahut matet me antropometër të shkurtër sipas Martinit. Pozita e subjekti është në qëndrim të drejtë të relaksuar, me krahun e majtë të shtrirë anash-poshtë, me shuplakë të kthyer nga trupi-poshtë. Matësi e vendos majën e pjesës së rrëshqitshme horizontale të antropometrit të shkurtër në pjesën e jashtme të ashtit të shpatullës (procesusakromialis), ndërsa, skajin tjetër në majën më të gjatë të gishtit të dorës së majtë. Rezultati shënohet në saktësi prej 0.1



Foto 3

**4. AGJASHU-** Gjatësia e shuplakës matet me antropometër të shkurtuar milimetrik dhe matet prej gjatësisë së nyjës së dorës deri të skaji i poshtëm i gishtit të mesëm (i gjatë). Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 0.1 cm.



Foto 4

**5. AGJRSHU-** Gjërësia e shuplakës matet me antropometër të shkurtuar milimetrik dhe e bënë matjen prej gishtit të vogël deri të gishti i madh (tërthorazi). Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 0.1 cm.



Foto 5

**6. AGJERBIK-** Matet me antropometër të shkurt, me krahë të lakuar ose me pelvimetër. Matësi qëndron pas tij dhe i vendos majet e krahëve të antropometrit në skajet e jashtme të të dy vazhduesve akromial të shpatullave duke e shtypur lehtë indin e butë. Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 0.1 cm.



Foto 6

**7. APEGJO-** Perimetri i gjoksit matet me shirit metrik në të cilin janë të shënuara milimetrat dhe centimetrat. I testuari qëndron në këmbë. Shiriti vendoset në rrafshin horizontal në nivel të artikulacionit të katërt kosto-sternal, duke kaluar mbi ulësen e poshtme të shpatullave dhe në përfundim të muskujve pectoralis major. Perimetri matet në fund të një frymënxjerrje, normale. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 cm.



Foto 7

**8. APEKR-** Perimetri i krahut matet me shirit milimetrik. Subjekti qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, me krah bri trupit dhe të relaksuar. Shiriti vendoset në pjesën më të gjërë të krahut. Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 1mm.



Foto 8

**9. APBEL-** Perimetri i belit është matur me shiritin milimetrik. Subjekti qëndron në pozitë të qëndrimit të drejtë. Matësi qëndron para subjektit i cili vendos shiritin matës në pozitë horizontale në nivel të kërthizës (umbilikusit), ose përafërsisht në pjesën më të ngushtë të belit. Rezultati shënohet me saktësi prej 1 mm.



Foto 9

**Pikat e matjeve perimetrike janë standardizuar dhe janë të paraqitura në Anthropometric Standardization Reference Manual.**

### 4.2.3. Grupi i instrumenteve matëse të ndryshoreve lëvizore

Hulumtimet gjithëpërfshirëse të hapësirave motorike (lëvizore) janë shumë të rralla, posaçërisht ato në të cilat faktori izolues interpretohet nga aspekti i mekanizmave funksional dhe mu për këtë lëmia e aftësive motorike është lëmia më e komplikuar e antropologjisë dhe për këtë është lëmi jo e studiuar sa duhet.

Në këtë hulumtim, në kuadër të ndryshoreve lëvizore, subjektet janë trajtuar në dhjetë ndryshore lëvizore, gjashtë teste nga lëvizjet bazike dhe katër teste të lëvizjeve situacionale, që mendojmë se e mbulojnë hapësirën e nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij hulumtimi.

#### 4.2.3.1. Testet lëvizore bazike

1. MVR 20M - Vrapimi në 20 metra starti i lartë
2. MKGJV - Kërcim së gjati nga vendi
3. MKLV - Kërcim nga vendi në lartësi
4. MGJM4kg. - Gjuajtja e medicinobollit 4 kg.
5. MGJT500gr. - Gjuajtja e topit 500 gr.
6. MTAPD - Tapingu me dorë

#### 4.2.3.2. Testet lëvizore situacionale

1. MVR9M - 3 vrapime rreth 9 metërshit, 3 gjuajtje në portë
2. MVZ6-9M - Vrapim zikzak në mes 6 dhe 9 metërshit
3. MGJ7M - Gjuajtje nga 7 metërshi
4. MV3KUND - Tri kundërsulme nga 6 metërshi

### 4.3. Përshkrimi i instrumenteve matëse lëvizore bazike

**1. MVR 20m -** Vrapim 20 metra starti i lartë.

Vrapimi kryhet në shtegun e gjatë prej 20 metrash nga vija e nisjes deri të vija e cakut.

Gjërësia e shtegut është 1.20m. I testuari nga pozita e nisjes së lartë, pas komandës “gati” dhe sinjalit për nisje, vrapon me shpejtësi maksimale distancën prej 20m. Koha matet nga momenti i sinjalit për nisje e derisa vrapuesi të kalojë me gjoks rrafshin vertikal mbi vijën e cakut. Rezultati shënohet me saktësi prej 0.1 sec.



Foto 10

**2. MKGJV -** Kërcim së gjati nga vendi.

Shkëputja kryhet nga vendi me të dy këmbët. U lejohën lëvizjet e hovit me duar, ndërsa këmbët vendosën mbrapa vijës së kërcimit. Kërcimi bëhet me forcë maksimale, duke kërcyer me këmbë të bashkuara. Kërcimi bëhet mbi dyshek, sa më gjat që të jetë e mundur. Gjatësia e kërcimit matet me centimetra, pra distancë në mes të vijës së nisjes dhe shenjës më të afërt të thembrës në dyshek. Prej tri tentimesh, shënohet rezultati më i favorshëm, madje prej 0.1 cm.



Foto 11

**3. MKLV**- Kërcim nga vendi në lartësi.

I testuari është i kthyer brinjazi prej shiritit centimetrik, së pari e ngritë krahun që duhet të jetë i shtrirë lart në të gjitha nyejt. Matet lartësia nga dyshemeja deri të gishti i mesëm, që shënohet me centimetra. I testuari nga qëndrimi vertikal i kthyer nga shiriti centimetrik i improvizuar, që është e lejuar lëvizja e krahut, kërcen dhe e prek shiritin me njërën dorë, varësisht nga është kthyer, në anën e majtë apo të djathtë. Pas matjes së lartësisë pa kërcim në shtrirjen e krahut dhe pas kërcimit nga vendi, e gjejmë lartësinë e shkëputjes nga vendi. Prej tre tentimesh shënohet rezultati më i favorshëm, madje prej 0.1 cm.



Foto 12

**4. MGJM4kg-** Gjuajtja e medicinobollit 4 kg.

I testuari duhet të jetë i shtrirë në shpinë, duart duhet të jenë të shtrira afër trupit dhe aty ku prekin gishtat e gjatë të duarve, aty shënohet vija nga fillon matja.

I testuari në atë pozitë merr topin e medicinobollit me të dy duart, që janë të shtrira mbrapa kokës dhe me tërë forcën e gjuan topin në gjatësi pa pasur të drejtë ta ndryshoj pozitën e trupit të shtrirë në shpinë.

I testuari gjuan tre herë, ndërsa shënohet rezultati më i mirë madje prej 0.1 cm.



Foto 13

**5. MGJT500gr.-** Gjuajtja e topit 500 gr.

I testuari merr topin që kishte diametrin e topit të tenisit, vendoset në pozitën diagonale dhe nga vendi me dorën aktive e gjuan topin sa më gjatë. Matja bëhet nga vija para këmbëve të gjuajtësit deri në vendin ku kishte prekur topi nga ajri në tokë.

I testuari gjuan tre herë dhe rezultati më i mirë shënohet në fletëtestim madje prej 0.1 cm.



Foto 14

**6. MTAPD -** Tapingu me dorë.

Me këtë test është vlerësuar shpejtësia e frekuencave të lëvizjes me amplitudë të caktuar.

3 MJETET-Një bankë dhe karrige e përshtatshme për moshën e subjektit, mbi bankë janë të vendosura dy pllaka me diametër 20 cm, të larguara njëra nga tjetra 51 cm (skajet e brendshme të pllakave).

Subjekti detyrën e fillon i ulur në karrige duke e vendosur dorën e majtë të shtrirë ndërmjet pllakave, ndërkaq të djathtën të kryqëzuar mbi të majtën me gishtrinjë mbi pllakë.

Detyrë e subjektit është që sa më shpejt që mundet ta takon njërën pastaj tjetrën pllakë në kohëzgjatje prej 30 sec. Takimi i të dy pllakave llogaritet një cikël i saktë.

Në fletëtestim të subjektit llogaritet çdo takim i dytë i pllakës (një cikel).



Foto 15

## 4.4. Përshkrimi i instrumenteve matëse të lëvizjeve situacionale

**1. MVR 9m -** 3 vrapime rreth 9 metërshit, 3 gjuajtje në portë.

Vija e startit është të vija ku takohen vija e 9 metërshit me vijën anësore. Në vijën e 9 metërshit përballë vijës së 7 metërshit vendosen në parket 3 topa me distancë njëri nga tjetri nga 1 metër.

I testuari ka për detyrë që nga vija e startit të vrapojë sa më shpejtë që është e mundur, ta marr topin e parë ta gjuaj në portë, të vazhdojë vrapimin deri të vija tjetër anësore, ku takohen vija e 9 metërshit dhe ajo anësore dhe kështu të vazhdojë vrapimin pa ndërprerë, derisa ti kryej tri gjuajtjet me top në portë. Në fletëtestim rezultatet shënohen me saktësi prej 0.1 sec.



Foto 16

**2. MVZ6-9m -** Vrapim zikzak në mes 6 dhe 9 metërshit.

Nga vija fundore tërheqim një vijë 2m. në drejtim të 9m. , ku prehet kjo vijë të 9m. dhe vendosim një konë druri, të njëjtën gjë e bëjmë edhe në anën tjetër të fushës, brenda këtyre dy konë të drurit vendosim edhe dy kona të tjera me distancë të njëjtë njëra me tjetrën, përreth vijës së 9m. Nisja është të vija fundore në mes 6-9m. në anën e majtë të fushës. Subjekti duhet të bëjë lëvizje zik-zake në mes 6-9m në drejtim të konave të drurit nga e para deri të e fundit. Pas kalimit të kësaj distance subjekti vazhdon vrapimin e zakonshëm në mes vijave të 6-9m, ku takohen vija e 9 metërshit dhe ajo anësore dhe kështu të vazhdoj vrapimin pandërprerë "vajtje ardhje vajtje" derisa t'i kryje tre gjuajtje me top në portë. Në fletëtestim rezultati shënohet me saktësi prej 0.1 sec.



Foto 17

**3. MGJ7m.** – Gjuajtje nga 7 metëshi

I testuari vendoset afër vijës së 7 metërshit i kthyer me shpinë nga porta. Para vetës ka 10 topa dhe ai sugjerohet se duhet të gjuhën 10 gjuajtje. Pasi ndihmësi i jep topin në dorë, i testuari është i obliguar që të bëj kthim nga vendi për 180 shkallë dhe të gjuaj në portë, ku në këndin e djathtë të sipërm të portës është e vendosur një tabllo me dimensione 50X50 cm, i testuari ka për të gjuajtur në cak (tabllo). Në fletëtestim shënohen vetëm goditjet në cak.



Foto 18

**4. MV3KS -** Tri kundërsulme nga 6 metërshat.

Vrapimi kryhet në fushën e hendbollit, nga 6 metërshi në 6 metërshin tjetër.

I testuari vendoset mbrapa vijës së 7 metërshit në vijën e 6 metërshit në shtegun e gjerë 120m. I testuari nga pozita e nisjes së lartë, pas komandës "gati" dhe sinjalit për nisje, vrapon me shpejtësi maksimale nga 6 metërshi i parë deri të 6 metërshi i dytë dhe këtë e vazhdon tri herë pa ndërprerje në sistemin "vajtje ardhje vajtje". Në fletëtestim rezultati shënohet më 0.1 sec.



Foto 19

Që të kryhen me sukses testimet e lartësuara, nevojitet matësi i kohës, i cili qëndron të vija e cakut dhe matë kohën, si dhe ndihmësi i tij i cili qëndron në vijën e startit dhe i sinjalizon të testuarit për nisje më komandën "gati" dhe "tash". Të testuarëve u bëhet me dije ta kalojnë distancën e paraparë me shpejtësi maksimale.

# 5. MËNYRA E ZBATIMIT TË HULUMTIMIT

I tërë programi dhe literatura si dhe informatat tjera për këtë hulumtim janë mbledhur në kuadër të projektit “Struktura e ndryshimeve të dimensioneve antropometrike, lëvizëse, dhe të lëvizjeve situacionale në mes të dy grupeve të hendbollit të superligës së Kosovës për të rinjë”.

Matjet janë bërë në prill të vitit 2008.

Në eksperiment janë përshirë 8 ekipe të hendbollit të supërligës së Kosovës për të rinjë, ku gjithsej kanë qenë të testuar 128 hendbollistë.

Matjet janë kryer me ndihmën e katër profesorëve të kulturës fizike, të cilët kanë qenë të përgatitur, me qëllim të minimizimit të gabimeve gjat matjeve. Matjet antropometrike, lëvizore dhe të lëvizjeve situacionale janë kryer në mbrëmje nga ora 16-17, nëpër palestrat sportive, ku mbaheshin ushtrimet. Në teste kanë marrë pjesë tre grupe nga pesë hendbollistë dhe janë udhëhequr nga matësi, i cili së pari ka demonstruar lëvizjet, pastaj hendbollistët i kanë ekzekutuar ato. Të testuarit gjat matjeve antropometrike kanë qenë të veshur me brekë, ndërsa gjat matjeve lëvizore në veshje sportive.

Të gjithë të testuarit në kohën e matjeve kanë qenë në gjendje të mirë psiko-fizike.

## 5.1. METODA E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Që të jetë i mundshëm interpretimi i rezultateve, ato janë përpunuar në programin SPPS, versioni 12.0, për windows.

Në këtë hulumtim është përfshi mostra e 128 hendbollistëve të superligës së Kosovës për të rinjë (juniorë)

Hulumtimi shkencor është bërë në përbërje të hapësirës antropometrike dhe lëvizore.

Metodat e aplikuara dhe mostra e të testuarve na mundësojnë realizimin e qëllimit të këtij hulmtimi shkencor.

Përpunimi i këtyre rezultateve është bërë në këto metoda statistikore.

Në hapësirën antropometrike dhe lëvizore janë llogaritur parametrat themelorë statistikorë:

1. Mesatarja aritmetikore.
2. Devijimi standard.
3. Rezultati max-min.
4. Masat e asimetrisë skew dhe kurt.

- Korelacioni në mes të ndryshoreve antropometrike dhe lëvizore,
- Kroskorelacioni ndërmjet ndryshoreve antropometrike dhe lëvizore
- Faktorizimi në hapësirën manifeste dhe latente të ndryshoreve me metodën e komponentëve kryesore ( rotacioni oblimin ).
- Analiza Diskriminative
- T-Testi për ndryshoret antropometrike dhe lëvizore ndërmjet dy grupeve.

# 6. REZULTATET DHE DISKUTIMET

## 6.1. Treguesit themelorë statistikorë në hapësirën antropometrike dhe lëvizore në matjet e hendbollistëve.

Në këtë hulumtim janë aplikuar nëntë ndryshore antropometrike, për të cilat mendohet se janë parametra të rëndësishëm për këtë punim.

Në tabelën nr. 1. janë paraqitur rezultatet themelore statistikore të ekipeve të hendbollistëve të tetë klubeve juniorë të superligës së Kosovës në Hendboll, të cilët kanë garuar në edicionin e garave në vitin 2007/08 të Republikës së Kosovës ato janë: Trepça, Kastrioti, Besa Famiglia, Prishtina, Kosova, Liridoni, Drenica, Vjosa. Në këtë tabelë janë paraqitur rezultatet themelore statisikore: rezultati minimal (min), maksimal (max.) mesatarja aretmetikore (mean) , devijimi standard (std. Dev.), masat e asimetrisë (skew dhe kurt) dhe numri i individëve.

Në bazë të rezultateve të fituara në tabelën nr. 1. në mes të rezultateve minimale dhe maksimale të reflektuara nga devijimi standard, vlerat janë paraqitur në suaza të normales, për arsye së kemi të bëjmë më një grup të seleksionuar dhe homogjen. Këtë e vërtetojnë edhe rezultatet e masave të asimetrisë, të cilat japin vlera të një grupi homogjen në aspektin antropometrik.

*Tabela 1. Treguesit themelorë statistikorë në hapësirën antropometrike në matjet e hendbollistëve*

| Ndryshoret | N | Minimum | Maximum | Mean | Std. Dev. | Skew. | Kurt. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **APESHA** | 128 | 47.90 | 99.80 | 68.76 | 10.65 | .801 | 1.115 |
| **ALARTE** | 128 | 158.00 | 197.00 | 177.53 | 6.70 | -.085 | .331 |
| **AGJAKRAH** | 128 | 68.00 | 89.00 | 78.90 | 4.45 | -.266 | -.627 |
| **AGJASHUP** | 128 | 17.00 | 25.00 | 20.16 | 1.75 | .891 | .136 |
| **AGJERSHP** | 128 | 19.00 | 26.00 | 22.48 | 1.44 | .182 | -.360 |
| **AGJABIKR** | 128 | 26.00 | 48.00 | 38.43 | 2.94 | -.400 | 2.582 |
| **APERGJOK** | 128 | 71.00 | 99.00 | 85.92 | 5.76 | .094 | -.049 |
| **APERBEL** | 128 | 62.00 | 98.00 | 75.58 | 7.35 | .571 | .434 |
| **APERKRAH** | 128 | 18.00 | 37.00 | 26.50 | 3.19 | .879 | 1.298 |

*Paraqitja grafike e matjeve të hendbollistëve në hapësirën antropometrike*



### 6.1. 1. Treguesit themelorë statistikorë në hapësirën lëvizore në matjet e hendbollistëve.

Në këtë hulumtim janë aplikuar dhjetë ndryshore lëvizore, për të cilat mendohet se e mbulojnë hapësirën e nevojshme për këtë hulumtim.

Në tabelën nr. 2. janë paraqitur rezultatet themelore statistikore të skuadrave të hendbollistëve të tetë klubeve të Ligës së parë të Kosovës në Hendboll, të cilët kanë garuar në edicionin e garave në vitin 2007/08 të Republikës së Kosovës ato janë: Trepça, Kastrioti, Besa Famiglia, Prishtina, Kosova, Liridoni, Drenica, Vjosa.

Në këtë tabelë janë paraqitur rezultatet themelore statisikore: rezultati minimal (min.), maksimal (max.) mesatarja aretmetikore (mean.) , devijimi standard (std. dev), masat e asimetrisë (skew dhe kurt) dhe numri i individëve.

Duke u bazuar në rezultatet e fituara në tabelën nr. 2. në mes të rezultatëve minimale dhe maksimale të reflektuara nga devijimi standard, janë të ndryshoret MKGJAT dhe MGJM4KG, që mund të themi së vlerat e tyre nuk përkojnë në normale për arsye se kemi të bëjmë më një grup të pa seleksionuar dhe jo homogjen. Rezultatet të masat e asimetrisë janë në suaza të normales dhe janë paraqitë rezultate simetrike.

*Tabela 2. Treguesit themelorë statistikorë në hapësirën lëvizore në matjet e hendbollistëve*

| Ndryshoret | N | Minimum | Maximum | Mean | Std. Deviation | Skew. | Kurtosis |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **MVR20M** | 128 | 2.96 | 4.12 | 3.46 | .22 | .204 | -.463 |
| **MTAPDOR** | 128 | 51.00 | 94.00 | 74.28 | 8.56 | -.484 | .647 |
| **MKGJAT** | 128 | 113.00 | 295.00 | 222.58 | 26.28 | -.057 | 2.663 |
| **MKLART** | 128 | 37.00 | 72.00 | 51.51 | 5.85 | .210 | .557 |
| **MGJM4KG** | 128 | 213.00 | 639.00 | 421.68 | 88.00 | .281 | -.113 |
| **MGJT500G** | 128 | 22.11 | 44.12 | 32.88 | 4.38 | -.161 | .120 |
| **MVR9M** | 128 | 13.12 | 17.51 | 15.48 | 1.24 | -.235 | -.942 |
| **MVRZIZAK** | 128 | 10.12 | 17.94 | 13.68 | 1.35 | -.444 | .367 |
| **MGJUAJ7M** | 128 | 1.00 | 9.00 | 4.77 | 1.96 | -.078 | -.875 |
| **MKUNDSU** | 128 | 13.12 | 18.63 | 15.50 | 1.12 | .285 | -.032 |

**Paraqitja grafike e matjeve të hendbollistëve në hapësirën lëvizore**



## 6.2. NDËRLIDHJET E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE MANIFESTE

### 6.2.1. Ndërlidhjet e ndryshoreve në hapësirën antropometrike manifeste të hendbollistëve

Në tabelën nr.3 është dhënë amëza e ndërlidhjeve ndërmjet ndryshoreve në hapësiren antropometrike të hendbollistëve. Në bazë të rezultateve shihet se në amëzën e ndërlidhjeve të ndryshoreve antropometrike janë fituar rezultate të larta dhe të vlefshme, e sidomos vlera të larta kanë dhënë ndryshoret në hapësiren antropometrike. Vlera më të larta kanë dhënë treguesit e dimensioneve të gjatësisë dhe volumit APESHA, ALARTE, APERGJOK dhe, APERBEL, APERKRAH, çka do të thotë se këto ndryshore kanë koeficient të lartë të korrelacionit, të cilët varirojnë deri në 796**. Ndërsa në ndryshoret tjera kanë paraqitur një lidhje të mirë, përveq AGJABIKR me AGJASHP, dhe AGJAKRAH me AGJASHP dhe AGJERSHP, të cilat kanë dhënë vlera shumë të vogla korelative.

*Tabela 3 Amëza e korelacioneve në hapësirën antropometrike të hendbollistëve*

| Ndryshoret | APESHA | ALARTE | AGJAKRAH | AGJASHUP | AGJERSHP | AGJABIKR | APERGJOK | APERBEL | APERKRAH |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **APESHA** | 1.000 | | | | | | | | |
| **ALARTE** | .508** | 1.000 | | | | | | | |
| **AGJAKRAH** | .345** | .602** | 1.000 | | | | | | |
| **AGJASHUP** | .174* | .197* | -.057 | 1.000 | | | | | |
| **AGJERSHP** | .213* | .284* | .014 | .761** | 1.000 | | | | |
| **AGJABIKR** | .546** | .424** | .423** | .011 | .115* | 1.000 | | | |
| **APERGJOK** | .784** | .357** | .260* | .220* | .255* | .458** | 1.000 | | |
| **APERBEL** | .796** | .273* | .168* | .296* | .328** | .411** | .729** | 1.000 | |
| **APERKRAH** | .692** | .168* | .236* | .202* | .222* | .458** | .735** | .685** | 1.000 |

## 6.3. NDËRLIDHJET E NDRYSHOREVE LËVIZORE MANIFESTE

### 6.3.1. Ndërlidhjet e ndryshoreve në hapësirën lëvizore manifeste të hendbollistëve

Në tabelën nr. 4 është dhënë amëza e ndërlidhjeve ndërmjet ndryshoreve në hapësirën lëvizore të hendbollistëve. Në bazë të rezultateve shihet së në amëzën e ndërlidhjeve të ndryshoreve janë fituar rezultate mjaft të larta dhe të vlefshme e sidomos vlera më të larta kanë dhënë treguesit e dimensioneve të forcës eksplozive dhe shpejtësisë së reflekseve: MVR20M , MTAPDOR, MKLART, MGJM4KG, MGJUAJT7M DHE MKUNDSU, çka do të thotë se këto ndryshore kanë koeficient të lartë të korelacionit deri në .551**. Ndërsa vlera të ulëta korelative kanë treguar ndryshoret MKGJAT me MGJT500G dhe MVRZIZAK.

*Tabela 4 Amëza e korelacioneve në hapësirën lëvizore të hendbollistëve*

| Ndryshoret | MVR20M | MTAPDOR | MKGJAT | MKLART | MGJM4K | MGJT500G | MVR9M | MVRZIZA | MGJUAJ7M | MKUNDSU |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| MVR20M | 1.000 | | | | | | | | | |
| MTAPDOR | -.500** | 1.000 | | | | | | | | |
| MKGJAT | -.204* | .144* | 1.000 | | | | | | | |
| MKLART | -.342* | .274* | .445** | 1.000 | | | | | | |
| MGJM4KG | -.467** | .425** | .181* | .509** | 1.000 | | | | | |
| MGJT500G | -.474** | .535** | .091 | .340** | .645** | 1.000 | | | | |
| MVR9M | .348** | -.417** | -.214* | -.251* | -.337** | -.454** | 1.000 | | | |
| MVRZIZAK | .291* | -.298* | -.081 | -.149* | -.253* | -.320* | .678** | 1.000 | | |
| MGJUAJ7M | -.252* | .388** | .295* | .277* | .345** | .421** | -.535** | -.270* | 1.000 | |
| MKUNDSU | .551** | -.429** | -.150* | -.386** | -.406** | -.390** | .389** | .274* | -.316** | 1.000 |

## 6.4. KROSKORELACIONET NË MES TË NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE LËVZORE

### 6.4.1. Kroskorelacionet ndërmjet ndryshoreve antropometrike dhe lëvizore në hapësirën manifeste të hendbollistëve

Në tabelën nr. 5. është dhënë amëza e ndërlidhjeve apo kroskorelacioni i skuadrave të hendbollistëve të tetë klubeve juniore të Ligës së parë të Kosovës në Hendboll, të cilët kanë garuar në edicionin e garave në vitin 2007/08 të Republikës së Kosovës dhe ato janë: Trepça, Kastrioti, Besa Famiglia, Prishtina, Kosova, Liridoni, Drenica, Vjosa.

Në tabelë janë paraqitur vlerat e ndërlidhjeve ndërmjet hapësirës antropometrike, e cila i ka nëntë ndryshore me hapësirën lëvizore e cila përbëhet prej dhjetë ndryshoreve.

Duke analizuar amëzën e kroskorelacioneve, vlerat e fituara janë të një niveli të mesëm deri të ai i lartë i probabilitetit, të cilat dallohen në grupime të shkallës së ndërlidhjes dhe në disa raste janë të larta e në disa jo, APESHA ka lidhmëri me të gjitha ndryshoret, përveç me ndryshoren e MKGJAT, e cila nuk ka lidhje të vlefshme korelative. Ndërsa testi ALARTE ka lidhje të rëndësishme me të gjitha ndryshoret, përveç me MKGJAT, MVR9M dhe MZIZAK ndryshore, me të cilat nuk ka vlera të një lidhje të lartë korelative. Poashtu edhe testet tjera kanë lidhmëri të cilat arrijnë vlerën mesatare të ndërlidhmërisë.

*Tabela 5 Amëza e kroskorelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike dhe lëvizore të hendbollistëve*

| Ndryshoret | APESHA | ALARTE | AGJAKRA | AGJASHU | AGJERSH | AGJABIK | APERGJO | APERBEL | APERKRA |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| MVR20M | -.313** | -.125* | -.147* | .061 | .008 | -.312** | -.309** | -.110* | -.287* |
| MTAPDOR | .264* | .258* | .239* | -.177* | -.138* | .344** | .218* | .101* | .175* |
| MKGJAT | .015 | .050* | .215* | .138* | .149* | .072 | -.004 | .036 | .025 |
| MKLART | .161* | .304** | .186* | .217* | .230* | .138* | .257* | .167* | .090 |
| MGJM4KG | .667** | .401** | .296* | .090 | .136* | .494** | .623** | .573** | .559** |
| MGJT500G | .551** | .289* | .239* | -.053 | -.059 | .452** | .479** | .349** | .424** |
| MVR9M | -.223* | -.075 | -.252* | .280* | .177* | -.101* | -.279* | -.126* | -.254* |
| MVRZIZAK | -.218* | -.087 | -.173* | .084 | -.034 | -.048 | -.258* | -.225* | -.259* |
| MGJUAJ7M | .184* | .155* | .238* | -.176* | -.179* | .072 | .178* | .049 | .106* |
| MKUNDSU | -.129* | -.143* | -.282* | .231* | .158* | -.216* | -.219* | -.027 | -.098 |

## 6.5. FAKTORIZIMI I HAPËSIRËS MANIFESTE

### 6.5.1 Faktorizimi i hapësirës antropometrike të hendbollistëve

Në tabelën nr. 6 janë paraqitur barazimet karakteristike nga amëza iniciale statistikore, të cilat shpjegojnë tërë sistemin e ndryshoreve antropometrike të dy grupeve. Me këtë rast janë ekstrahuar tre faktorë me rrënjë të vlefshme karakteristike (llambda) të cilat shpjegojnë me 79.5 % të variancës së përbashkët të sistemit të ndryshoreve, (tab.6) të cilat mundësojnë izolimin e tre komponenteve kryesore.

